

Bashkia e Himarës vijon me implementimin e projektit IDEA – Investment Development and Empowerment Actions. Ky projekt, i cili ka nisur punën në fillim të vitit 2018 dhe që zhvillohet në kuadër të programit Interreg IPA CBC “Greqi – Shqipëri 2014 – 2020” ka si qëllim kryesor fuqizimin dhe përmirësimin e mjedisit të sipërmarrjeve sociale në territorin ndërkufitar përmes ndërtimit të mekanizmave financiar dhe përmirësimit të aksesit në financë.

Përse lindi nevoja për një projekt të tillë?

Ekonomia sociale dhe ndërmarrja sociale identifikohen si faktorë të rëndësishëm të kohezionit social dhe ekonomik në të gjithë Evropën, duke kontribuar në ndërtimin e një ekonomie pluraliste dhe elastike. Ata krijojnë vende pune, sigurojnë produkte dhe shërbime inovative dhe promovojnë një ekonomi më të qëndrueshme, ndërsa kontribuojnë në integrimin e demokracisë në ekonomi dhe mbrojtjen e mjedisit. Ata gjithashtu krijojnë këndvështrime të reja dhe shpresa për të ardhmen dhe ndihmojnë qytetarët të rimarrin kontrollin mbi vendimet që ndikojnë në jetën e tyre.

Është një besim i zakonshëm që zhvillimi i sektorit të ekonomisë sociale në Greqi dhe Shqipëri ka potencialin për të formuar njëkohësisht një faktor të rëndësishëm të strategjisë së daljes nga kriza dhe zhvillimit lokal / rajonal, një burim i rëndësishëm për mirëmbajtjen dhe krijimin e vendeve të punës dhe – pa dyshim një katalizator efektiv në riformatimin e strukturës ekonomike dhe sociale të secilit vend.

Faktori kryesor që pengon zhvillimin e sipërmarrjes sociale në rajonet e Epirit dhe Shqipërisë së Jugut është mungesa e mjeteve financiare-investuese. Problemi është maksimalizuar pasi sipërmarrësit socialë në shumë pak raste kanë fonde të veta ndërsa praktikisht janë të përjashtuar nga kreditë bankare.

Çfarë synohet?

Objektivi i përgjithshëm i projektit është “Përmirësimi i kapaciteteve ndërkufitare për të mbështetur sipërmarrjen, mbijetesën e biznesit dhe konkurrencën” në lidhje me sektorin e sipërmarrjes sociale, ku përfshihet:

-Përmes zhvillimit të instrumenteve dhe modeleve financiare hibride dhe trainimit, mentorimit dhe ngritjes së kapaciteteve, përmirësimin e kapaciteteve të ndërmarrjeve sociale dhe operatorëve social;

-Përmirësimin e mbijetesës së ndërmarrjeve sociale ndërkufitare duke u dhënë atyre mundësi për financim;

-Krijimin e skemave bashkëpunuese të ndërmarrjeve sociale përmes rrjetëzimit dhe ndërtimit të mekanizmave që synojnë mbështetje afatgjate;

-Rritjen e bashkëpunimit të ndërmarrjeve sociale në zonën ndërkufitare.

Për më tepër, projekti kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe në zhvillimin e një ekonomie smart.

Ky projekt është i financuar nga Bashkimi Evropian dhe fondet kombëtare të Shqipërisë dhe Greqisë përmes programit Interreg IPA CBC “Greece – Albania 2014 – 2020”. Partnerët e tjerë në këtë projekt

janë: AULEDA – Agjencia e Zhvillimit Ekonomik Lokal Vlore (në cilësinë e partnerit lider), Universiteti i Janinës, Bashkia e Artës dhe Organizata “Three Third Society”.

**"Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian, vendeve pjesëmarrëse dhe Autoritetit Menaxhues".